



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Misioni i OSBE-së mbështet arsimimin në gjuhën boshnjake

Me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, fakulteti i edukimit në Prizren ka filluar bashkëpunimin me disa universitete në Bosnje dhe Hercegovinë me qëllim që të shtojë numrin e arsimtarëve në gjuhën boshnjake.

Kur Fadija Huduti shkon në punë në mëngjes, ajo duhet t'ia përkujtoj vetes se nuk do ta ligjëroj lëndën për të cilën është shkolluar – gjuhën ruse. Fadija ka dhënë rusisht nga viti 1990 deri në vitin 1999, por tani ajo u mëson gjuhën angleze nxënësve nga tetë deri në 14 vjeç që ndjekin mësimin në gjuhën boshnjake në fshatin Pllanjan afër Prizrenit, në jug të Kosovës – jo se dëshiron por sepse s'ka kush tjetër.

Para intervenimit të NATO-s në vitin 1999, në Kosovë kanë ekzistuar dy sisteme të arsimit: sistemi formal i arsimit në gjuhën serbe dhe ai joformal në gjuhën shqipe. Menjëherë pas intervenimit, u themelua sistem i ri i arsimit nën administratën e OKB-së dhe Ministrinë e Përkohshme të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Arsimi formal tani ofrohet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke, kurse arsimi në gjuhën serbe ofrohet përmes sistemit paralel nga Ministria Serbe e Arsimit.

Por, arsimimi i mësuesve në gjuhët tjera përveç gjuhës shqipe është i pamjaftueshëm. Si rezultat, ka mungesë të stafit mësimor dhe cilësi jo të mirë të arsimit.

Mungesa e arsimtarëve të kualifikuar

Shembulli i Fadijes dhe shkollës së saj është ilustrim i mirë. Shkolla në të cilën punon ajo ka 218 nxënës të komunitetit boshnjak, por nuk ka arsimtarë boshnjak të kualifikuar të matematikës, biologjisë, gjeografisë, historisë, edukatës qytetare, artit figurativ, muzikës dhe edukatës fizike, kështu që arsimtarët që nuk janë të kualifikuar për këto lëndë improvizojnë për ta mbuluar mungesën. “Kam filluar të jap lëndën e gjuhës angleze për t'iu dhënë nxënësve një bazë mbi të cilën do të mund ta vazhdojnë shkollimin, por më duhet ta pranoj se më duhet shumë më shumë mund se sa kur jap gjuhën ruse apo boshnjake,” thotë Fadija.

Klemen Miklavic, këshilltar për arsim të lartë në Misionin e OSBE-së, thotë se ky problem është akut. “Me rënien e cilësisë së arsimit, komunitetet jo-shumicë rrezikojnë përjashtimin shoqëror, madje edhe asimilimin.”

“Misioni i OSBE-së ka filluar ta adresoj këtë çështje në fillim të vitit 2008,” shpjegon Miklavic. “Jemi përqendruar në përgatitjen e arsimtarëve të ardhshëm për mësimdhënie në gjuhën boshnjake në shkollat fillore dhe të mesme.”

Gjithsej 6,000 nxënës ndjekin shkollimin fillor dhe të mesëm në gjuhën boshnjake në mbarë Kosovën, shumica nga ta boshnjak por edhe një numër i vogël goran.

Programet mbështetëse të OSBE-së

Aktualisht Misioni është në zbatim të një programi për të ndihmuar fakultetin e edukimit në Prizren, i cili është pjesë e Universitetit të Prishtinës dhe një nga dy fakultetet që ofrojnë arsim të lartë në gjuhën boshnjake.

Fakulteti në Prizren ka mungesë të kuadrit mësimor dhe mezi siguron mësim në tri programet ekzistuese: të mësuesisë, si dhe të gjuhës dhe letërsisë boshnjake dhe shkencave teknologjike e kompjuterike për arsimtarë të shkollave të mesme.

Esad Kurjeshepi, asistent profesor në fakultetin e edukimit në Prizren, thotë se mundohen të sjellin profesorë nga Serbia jugore dhe Bosnja e Hercegovina për t'i mbajtur lëndët, por shpesh duhet t'i anulojnë vizitat për shkak të motit të ligë dhe rrugëve të këqija.

Për të vendosur bashkëpunim të qëndrueshëm në mes të fakultetit në Prizren dhe fakulteteve të edukimit në Bosnje dhe Hercegovinë, Misioni i OSBE-së ka blerë pajisje për video-konferencë në mars të vitit 2009. Me ndihmën e Misionit, Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Sarajevës me 25 maj dhe Universitet e Mostarit dhe Tuzllës me 4 qershor.

“Me nënshkrimin e marrëveshjeve, plan-programi në Prizren në vitin e ardhshëm akademik do të përfshij mësimin nga distanca si dhe mësim me prezencën fizike të profesorëve nga Tuzlla, Mostari dhe Sarajeva,” thotë Miklavac. “Do të mundësohen pesë lëndë shtesë, kurse lëndët tjera do të përfshihen në të ardhmen. Që nga viti 2009-2010, studentët do të mund të regjistrohen në departamentin e ri, të katërtin, për arsimtar të matematikës për shkolla të mesme.”

Investim në staf akademik

Megjithatë, jo të gjitha problemet kanë gjetur zgjidhje. Departamentet për arsimtarë të biologjisë dhe kimisë për shembull akoma nuk janë themeluar. Miklavac thotë se Misioni po përpiqet të ndihmoj edhe në këtë drejtim. “Po punojmë për të përshpejtuar fillimin e programeve të reja dhe çka është më me rëndësi, po punojmë për të shtuar numrin e stafit universitar këtu në Kosovë.”

Në vitin e ardhshëm akademik, Misioni do të mbuloj shpenzimet për tre studentë të nivelit master për t'u shkolluar në njërin nga universitetet në Bosnje dhe Hercegovinë për t'u bërë profesorë universiteti. “Presim që Universiteti i Prishtinës ta vazhdoj këtë praktikë,” thotë Miklavac.

“Përgatitja e profesorëve do të ndihmoj në përhapjen e arsimimit në gjuhën boshnjake dhe në ruajtjen e kulturës së këtij komuniteti.”

Pritjet e Fadijes janë më modeste – ajo shpreson që arsimtarë të rinj të kualifikuar do të arrijnë së shpejti. “Ka kohë që unë dhe kolegët e mi japim lëndë që nuk janë tonat. Mendoj se u kemi borxh fëmijëve që t'u ofrojmë arsimim adekuat,” përfundon ajo.